



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 70 datë 27.12.2022

**PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 1, DATË 22.1.2016 “PËR MIRATIMIN E
TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË
NDRYSHUAR**


Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.3. shkronja “a”, “b”, nenit 23, nenit 35, pika 5, shkronja “a”, nenit 54 shkronja “f”, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë së Shkodrës, sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR



Brisela KADIA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

A blue ink signature of Denis Lesha, the Secretary of the Municipal Council, written over a horizontal line.

Denis Lesha

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.12.2022

SHTESE NË KAPITULLIN III “TARIFAT VENDORE”

III.4 Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Shkodër

III.4.8. Tarifa shërbimi të tjera. (Tarifa shërbimi nga institucionet e kopshteve dhe çerdheve)

Rubrika Përfshirje (shitesë)

- Fëmijë që i përkasin kategorisë me aftësi të kufizuar që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet publike sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko Ligjor.

Sqarime (shitesë)

- Fëmijë që i përkasin kategorisë me aftësi të kufizuar që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet publike sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko Ligjor. Komisioni i Njesise arsimore të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues, dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. Në mënyrë që lehtësitë të jenë me efekt në rritjen e përfshirjes dhe integritet të fëmijëve me aftësi të kufizuara në çerdhe dhe kopshte, ato duhet të shoqërohen me caktimin e mësuesve ndihmës shitesë, që do të mbështesin këto fëmijë në kopshtet/çerdhet publike.